



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile/penale, të shpallur me vendimin nr. 79, nr. 80, nr. 81 datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj* | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Bledar Bajri | (anëtar) |
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |

8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile/penale, të shpallur me vendimin nr. 79, nr. 80, nr. 81 datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Sipas njoftimit të bërë, kemi një mbledhje të radhës së ditës së sotme, po për shkak të urgjencës së trajtimit të çështjeve, kemi këtë njoftim në momentin e fundit për të realizuar këtë mbledhje në lidhje me efektivitetin dhe funksionalitetin e sistemit, për plotësimin e vakancave dhe njëkohësisht për të përshpejtuar procedurën për shpalljen e pozicioneve të magistratëve të cilët kanë përfunduar studimet pranë Shkollës së

Magjistraturës dhe kanë kryer procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe të emërimit të tyre si magjistrat, për vitin akademik 2023-2024.

Për këto rrethana, një pjesë e anëtarëve janë prezent në sallë, znj. Plaku, z. Hado, z. Bajri, z. Tabaku, z. Kurushi, dhe unë, ndërsa online është znj. Muçaj, z. Koça dhe znj. Rupa.

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ka të pamundur objektivisht për të qenë prezent në këtë mbledhje (nuk do jetë prezent). Gjithashtu edhe zonja Muçi, sikundër edhe dje, edhe sot e ka të pamundur për të qenë prezent në këtë mbledhje.

Në vijim të kësaj mbledhjeje, për shkak të krijimit të kuorunit, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Ndonjë diskutim keni mbi rendin?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Nuk kemi diskutime për rendin e ditës.

Kam vetëm një diskutim, që të gjitha relacionet e Komisionit tonë, edhe në mirëkuptim dhe bashkërendim të veprimeve me anëtarët e Komisionit, do t'i lexoj unë. Edhe për efektivitet, kohë dhe gjithçka, do t'i lexoj unë të gjitha materialet që ne kemi dërguar si Komision. Në materiale është përcaktuar edhe relatori për çdo relacion që është përpiluar, vetëm prezantimin e tyre po e bëj unë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Ka ndonjë mendim ndryshe? Jo!

Atëherë, e bëj me dukje edhe faktin që do lodheni, për shkak se edhe keni përgatitur këto materialet dhe njëkohësisht do t'i prezantoni.

Vazhdojmë me pikën e parë të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e

të drejtës civile/penale, të shpallur me vendimet nr. 79, nr. 80, nr. 81 datë 20.02.2024...”. Nuk po bëjmë këtë përsëritjen “për më tej fjalën z. Kurushi” sepse ju sapo e deklaruat që të gjitha këto materiale do prezantohen nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, nëpërmjet jush.

Zoti Kurushi fjala për ju!

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar kolegë, të pranishëm dhe ata që janë “online”!

Pa humbur kohë po filloj relacionin që shoqëron projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile/penale (janë alternative kërkesat e bëra paraprakisht nga kandidati zoti {...}) të shpallur me vendimin nr. 79, nr. 80, nr. 81, datë 20.02.2024”.

Siç dihet, me vendimet nr.73 - nr.81, të vitit 2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e nëntë procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile. (*dhe penale*).

Brenda afatit të kandidimit në këto pozicione të lira shprehu interesin edhe kandidati {...}.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit, mbështetur në pikën 9, të vendimit 79/2024, 80/2024 dhe 81/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 127, datë 11.03.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

Me vendimin nr. 140, të vitit 2024, Këshilli vendosi: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidatët, duke përfshirë edhe verifikimin e kriterëve ligjore për kandidatin z. {...} për pozicionet e lira në lëvizjet paralele që ai kishte bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përfundim të verifikimit për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale, konkretisht të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore

në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të kandidimit të tij për lëvizjes paralele, Këshilli, me vendimin nr. 343, datë 09.07.2024, vendosi: Kualifikimin z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 80 dhe nr. 81 të vitit 2024.

Ndërsa me vendimin nr. 343, datë 09.07.2024, Këshilli vendosi: Vijimin e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 79, të vitit 2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}.

Ju bëj me dije. Kanë qenë dy situata të z. {...}. Një situatë kur ai është kualifikuar për pozicionet e lira të shpallura në fushën e së drejtës penale dhe për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile ne si Komision kemi shkuar tek gjetja për shkak të diskutimit që lidhej me përvojën minimale specifike brenda 5 viteve të fundit nëse zoti {...} e kishte në fushën e së drejtës civile ose jo. Kjo është arsyeja që ka qenë në fazën e verifikimit të mëtejshme edhe ky komponent (ky kriter), prandaj kemi dalë me një përfundim nëse duhet të kualifikohej ose nuk duhej të kualifikohej z. {...} në pozicionin në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 79 të vitit 2024. Pra ka qenë i kualifikuar për dy dhe për një nuk ishte i kualifikuar (ishte në proces verifikimi, pa përfunduar).

Më datë 20.09.2024 z. {...} paraqiti kërkesën për tërheqjen nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile/penale, shpallur pra me vendimet nr. 79, 80, 81, (pra për tre, që ne dy prej të cilëve i kishim bërë kualifikimin, ai ka paraqitur kërkesën për dorëheqje), ka parashtruar se: “...Duke vlerësuar pozicionet ku kam aplikuar dhe mundësinë e aplikimit në të ardhmen, me anë të kësaj kërkesë kërkoj të heq dorë nga aplikimet e mia për lëvizjet paralele në fushën e së drejtës civile dhe penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr.79, të vitit 2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dy pozicionet në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr.80 dhe nr.81, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndodhur në këto rrethana, meqenëse kandidati heq dorë nga vazhdimi i garës për tre pozicionet, një në fushën civile dhe dy në fushën penale, për të cilat ai është kualifikuar në këto dy të fundit në fushën penale, ne si Komision i Zhvillimit të Karrierës, i propozojmë Këshillit përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile/penale, të shpallur me vendimet nr. 79, 80, 81, datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}.

Ky përfundim mbështetet ndër të tjera në nenin 8, pika 6, të nenit 43, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 320, datë 17.09.2020, si dhe në vendimet konkrete për të cilat ne kemi bërë edhe shpalljet e tyre, nr. 79, 80, 81, datë 20.02.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile/penale, të shpallur me vendimin nr. 79, nr. 80, nr. 81 datë 20.02.2024, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, për kandidatin znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj*</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Albens Tabaku</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, për kandidatin *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Kalojmë tek pika tjetër e këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024”.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Është e njëjta situatë, siç prezantua edhe për zotin {...}, është e njëjta situatë

ligjore.

Me vendimet e datës 20.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi 14 procedura të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë, ndër to me vendimin 76 dhe 81, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile dhe penale.

Brenda afatit të kandidimit ka shprehur interesin edhe kandidatja, në këtë rast zonja {...}. Brenda afatit të kandidimit ajo ka shprehur interesin për pozicionet nr. 76 që i përket fushës së drejtës civile dhe pozicionin 81, datë 20.02.2024, që i përket fushës së të drejtës penale.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, mbështetur në pikën 9 të vendimit nr. 76 dhe 81, të vitit 2024, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 127, të vitit 2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose që mund të kenë dy vlerësime. U hapën procedurat edhe për verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për zonjën {...}.

Në përfundim të procedurës, Këshilli me vendimin nr. 164, datë 03.04.2024, vendosi: Kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 81, në të njëjtën datë, 20.02.2024.

Më tej, pasi përfunduar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozoi më tej, vijoi më tej procedurat për fillimin e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjet paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet përkatëse, të cilat ne i kemi bërë të ditur, janë pjesë e relacionit (s'po i përmend një nga një të gjitha vendimet por janë në këtë relacion, janë përmendur edhe në ditën e djeshme, pasi ky relacion është vijim i punës së ditës së djeshme të Këshillit). Relator përzgjedhjeje për pozicionin nr. 81 ishte z. Koça, dhe unë thashë që këtë relacion do ta prezantoj unë ditën e sotme.

Më datë 17.04.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75, Kreu VI, të

vendimit të tij nr. 320, të vitit 2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele”, kandidati u njoftua për vendimin nr. 205, të vitit 2024 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizje paralele, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit, për të cilin kandidatja ka qenë dakord.

Më tej zonja {...} në vijim të procedurës së përzgjedhjes për pozicionet që unë i përmenda deri tani, ka paraqitur një kërkesë për tërheqjen e saj nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionet e lira nr. 76 dhe nr. 81, në fushën e të drejtës penale dhe civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kërkesa është protokolluar me aktet nr. {...} prot., dhe nr. {...} prot., datë 20.09.2024.

Në përmbajtje të kërkesës kandidatja njofton tërheqjen nga kandidimi i saj për pozicionet që përmenda më lart. Arsyeja e tërheqjes lidhet edhe me kandidimet e reja që kandidatja ka bërë për pozicionet e shpallura tashmë me vendimet e fundit që ka marrë Këshilli për 5 pozicione të lira në fushën e së drejtës civile dhe penale në lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ndodhur në këto kushte, ne i propozojmë Këshillit, për shkak të tërheqjes nga kandidimet e mëparshme për pozicionet 76 dhe 81, datë 20.02.2024, përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për këto pozicione ku më përpara kandidatja kishte shprehur interesin për vijimin e garës dhe më pas tërhoqi këto kërkesa në këto dy pozicione.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe civile, të shpallur me vendimin nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça; relatohet nga z. Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj**** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Bledar Bajri*** (anëtar)

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça; relatohet nga z. Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Jemi tek projektvendimi “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Është një situatë të cilën unë e relatova dje, nëse kolegët e kanë parasysh relativimin e ditës së djeshme për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore, se çfarë situatë specifike kishte z. {...}. Ai kishte katër kërkesa në proces por një prej të cilave që ishte ngritje në detyrë kishte marrë një vendim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që atij nuk i bëhej vlerësimi për shkak se nuk mund t’i bëheshin vlerësimet për atë pozicion; dhe ishte një vendim i formës së prerë, ku zoti {...} në këtë pikë nuk përmbush ato kriterë që kërkon pozicioni sipas nenit 48 të ligjit “Për statusin.

Kështu që realisht zoti {...} ka tre kërkesa që ka shprehur interesin për procedurat e lëvizjes paralele.

Kërkesa e fundit e tij për të cilën ne kemi bërë verifikimet përkatëse në tre kriteret ligjore (përvojën specifike profesionale, të pasjes ose jo të masës disiplinore në fuqi si dhe të mospasjes së situatës së papajtueshmërisë ambientale), janë kërkesa të cilat janë verifikuar së fundi nga ana jonë, por një pjesë e tyre, sidomos për kriteret e papajtueshmërisë ambientale dhe kriterin e përvojës specifike minimale ne i kemi marrë të dhënat nga kualifikimet që i janë bërë zotit {...} në procedurat e mëparshme të lëvizjes paralele. Dhe ju bëj me dije se për pozicionet nr. 80 dhe 81 të shpallur me vendimin e datës 20.02.2024 është bërë kualifikimi i z. {...} duke iu referuar përvojës specifike profesionale, pra në 5 vitet e fundit të ketë një vit përvojë në fushën përkatëse. Ne e kemi bërë verifikimin, kemi marrë ato të dhëna dhe me vendimin që ka marrë Këshilli nr. 193, datë 09.04.2024, ne e kemi kualifikuar z. {...} për më tej për vijimin e procedurave që i referohet situatës së lëvizjes paralele të tij për pozicionet nr. 80 dhe 81. Është e njëjta situatë nga prilli deri në muajin shtator ndodhet në të njëjtën gjykatë, ndodhet në të njëjtën situatë, përvoja është e njëjtë në atë fushë. Ndoshta e ka shtuar edhe më tepër

përvojën për shkak të kohës më të gjatë që ne po shqyrtojmë kërkesën e fundit të tij.

Ndodhur në këto kushte, ne i propozojmë si Komision, Këshillit, kualifikimin e z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur në fushën e së drejtës penale me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, pasi një verifikim i parë është bërë dhe është plotësuar edhe me verifikimet e tjera që është bërë për pozicionin nr. 493.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Pro.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj**** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Bledar Bajri*** (anëtar)

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Kemi sjellë projektvendimin e radhës “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024”.

Siç e përmenda edhe në relacionin e parë që ne miratuam për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet 79, 80, 81 për z. {...}, unë e përmenda më përpara që për pozicionet 80 dhe 81 që i përkisnin fushës së të drejtës penale të shpallur në datë 20.02, zoti {...} ka qenë i kualifikuar në ato pozicione. Ky vendim është marrë nga ana e Këshillit me nr. 343, datë 09.07.2024. pra në muajin korrik 2024 ne kemi marrë vendimin për kualifikimin e z. {...} në dy pozicione në fushën e së drejtës penale. Jemi në muajin shtator. Janë të njëjtat situata, pozicionet për të cilat ai ka shprehur interesin janë pozicione në fushën e së drejtës penale dhe janë të njëjtat kritere në lëvizjes paralele, është e njëjta gjykatë, janë të njëjtat kritere ligjore të cilat ne i kemi verifikuar dhe mbas këtij verifikimi kemi marrë vendimin për kualifikimin e tij në datë 09.07.2024.

Kështu që ndodhur në këto kushte, përtej atyre verifikimeve, kemi bërë edhe ato verifikimet plotësuese kryesisht që lidhen me faktin nëse ka ndonjë masë disiplinore në fuqi apo jo z. {...} nga muaji korrik deri në ditën e sotme që po prezantoj relacionin, dhe nga këto verifikime rezulton që nuk ka asnjë pengesë ligjore që do të pengonte kualifikimin e z. {...} për dy pozicionet e shpallura në fushën e së drejtës penale, nr. 492 dhe 493.

Ndodhur në këto kushte, unë i propozoj Këshillit kualifikimin e tij për këto dy pozicione të shpallura në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pozicionet 492 dhe 493, të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 13.09.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Jo! Vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.491 dhe nr.493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça; relatohet nga z. Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Gentiana Muçaj*</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Bledar Bajri</i> | <i>(anëtar)</i> |

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.491 dhe nr.493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça, relatohet nga z. Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me

vendimin nr.491 dhe nr.493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Klodian Kurushi: Relacioni i radhës ka të bëjë me kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.491 dhe nr.493, datë 13.09.2024”.

Është një situatë e ngjashme me situatat e dy kolegëve që unë i përmenda më lart. Edhe për zonjën {...} ne, ndërmjet të tjerave, kemi bërë kualifikimin e saj për pozicionin nr. 81 të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që i përket fushës së të drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 20.02.2024. E kemi kualifikuar duke iu referuar kritereve ligjore që parashikon neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe kualifikimi i saj është bërë me vendimin (pasi plotësonte kriteret ligjore për këtë pozicione) me vendimin e Këshillit nr. 164, datë 03.04.2024. pra në muajin prill të vitit 2024 ne e kemi kualifikuar zonjën {...} për vijimin e procedurës në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të hapur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sot ajo ka shprehur interesin, ka paraqitur kërkesën e saj për dy pozicione, që i përkasin po fushës së të drejtës penale, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kështu që kriteret ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, janë të njëjta dhe procedura e verifikimit është e njëjtë. Kështu që ajo plotëson kriteret e përvojës profesionale minimale dhe tërësore që parashikon neni 43 i ligjit “Për statusin”; plotëson kriterin e mospasjes masë disiplinore, si dhe kriterin e tretë të mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale mbi bazën e verifikimeve që kemi bërë ne në Këshill. Ndodhur në këto kushte, referuar nenit 43, ne i propozojmë Këshillit që të pranojë kërkesën tonë/propozimin tonë, për të bërë kualifikimin e zonjës {...} dhe të vijojë më tej procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet 491, 493 datë 13.09.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.491 dhe nr.493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

6.1 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;

6.2 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;

6.3 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;

6.4 Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarës {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;

6.5 Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;

6.6 Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

27

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 25.09.2024 (Pika 6)***

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Gentiana Muçaj** (anëtare)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Bledar Bajri* (anëtar)
7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashinë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

- 6.1 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;
- 6.2 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;
- 6.3 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;
- 6.4 Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarës {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;
- 6.5 Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë;
- 6.6 Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë; Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë; Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë; Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarës {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë; Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë; Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë”. Këto nënpika janë pjesë e këtij rendi dite. Fillimisht duhet të diskutohet hapja e pozicioneve të lira. Në eventualitet të vendimmarrjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të vazhdohet me njoftimet për të shprehur pëlqimin magjistratët përkatës sipas rastit, në eventualitet të miratimeve apo jo për hapjen e këtyre vendeve të lira. Për më tej fjalën zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë fillimisht ne kemi paraqitur në një relacion, për shkak të situatave të ngjashme, tre projektvendime “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë”, është hapja e procedurës së transferimit fillimisht dhe ky transferim do t’u njoftohet paraprakisht kandidatëve plotencialë të cilët kanë kandiduar edhe në procedurat e lëvizjes paralele, për të cilat në këto procedura ata janë kandidatë të vetëm thuajse, pasi kanë në garë dy vlerësime dhe ajo i veçon dhe për ta nis procedura e verifikimit të kriterëve ligjore. Kështu që do filloj të bëj relatin për tre projektvendimet që i referohen situatës së hapjes së procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicionet e lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Po t’i referohemi, shkurtimisht po e përmend sepse është një relacion i ngjashëm me relacionin që ne e kemi prezantuar në datën 31 korrik të vitit 2024, ku ne kemi bërë transferimet e përkohshme në një situatë të ngjashme, për disa gjyqtarë, nga gjykatat e juridiksioneve të përgjithshme, në rrethe, i kemi transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Është e njëjta situatë, janë të njëjtat mekanizma që do të zbatohet në këtë rast.

Situata e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka një strukturë organizative prej 80 gjyqtarësh, organika në fakt është 64 dhe efektivisht në detyrë janë 52 gjyqtarë. Pra nga 80 gjyqtarë, efektivisht në detyrë janë 52 gjyqtarë. Ndodhur në këto kushte ne kemi paraqitur në relacionin tonë edhe strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë në formën e tabelës ku do të gjenden të pasqyruar të gjithë gjyqtarët, ato që kanë marrë leje, ato që janë efektiv në punë, ata që kanë transferime të përkohshme në Gjykatën e Tiranës, ata që janë të komanduar, pra është një pasqyrë e plotë dhe e detajuar e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Tiranës, e prezantuar ditën e sotme nëpërmjet këtij relacioni.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku në organikën e saj janë 80 gjyqtarë, efektivisht në detyrë janë 52 prej tyre. Në strukturën

organizative të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka vakanca të përkohshme, për disa shkaqe.

Shkaku i procesit të rivlerësimit kalimtar, që janë 10 gjyqtarë të shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Të gjithë emrat janë të pasqyruar në relacion. Unë nuk po i përmend një nga një; qenies anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kemi zonjën Plaku dhe është vakancë e përkohshme për sa kohë zonja Plaku është anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda mandatit të saj; qenies i komanduar të dy gjyqtarëve: znj. {...} dhe znj. {...} që janë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor; leje të tjera që janë leje lindje (një gjyqtare) si dhe pezullim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që është një gjyqtar. Këto janë vakancat e përkohshme.

Në strukturën organizative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka edhe vakanca të përhershme (gjithsej janë 15), nga të cilat 12 pozicione të lira janë të shpallura dhe janë në proces transferimi nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Gjatë vitit 2023 për të përmirësuar situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli ka përdorur dy mekanizmat: i) lëvizjen paralele; ii) transferimin e përkohshëm me pëlqim, të cilat ne i kemi aplikuar dhe besoj se ato kanë dhënë edhe rezultat në uljen e numrit të çështjeve që po gjykohen për secilin gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë statistikën aktuale të ecurisë së përfundimit të procedurave të lëvizjeve paralele, Komisioni vlerëson se këto të fundit mund të kërkojnë pak kohë, pra procedurat e lëvizjes paralele ose transferimet përfundimtare të gjyqtarëve në gjykatat ku ata kanë aplikuar, dhe këto njëkohësisht janë procedura të ndërlydhura edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që kandidojnë në këto pozicione.

Ndodhur në këto kushte, duke vlerësuar eksperiencën aktuale në lidhje me kohëzgjatjen e madhe të procedurave të vlersimit ne si Komision bëjmë propozimet tona përkatëse që lidhen me transferimet e përkohshme me pëlqim në pozicionet që ne i

kemi shpallur dhe normalisht në këtë rast pëlqimin ne e propozojmë që t'i kundërdrejtohet kandidatëve të cilët kanë dhënë pëlqimin e tyre për t'u transferuar përfundimisht nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në ato pozicione të cilat unë i përmenda më lart në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i referohemi kryesisht pozicioneve në fushën e së drejtës penale, pra tre pozicioneve në fushën e së drejtës penale. Kështu që edhe transferimet e përkohshme do t'u kundërdrejtohen kandidatëve potencial fitues në tre pozicionet në fushën e së drejtës penale që janë hapur së fundmi me vendime të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këtë optikë të vlerësimeve të Komisionit, ne i propozojmë Këshillit hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për tre pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Bazohemi si më poshtë:

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” (gjithsej 3 projektvendime për 3 magjistratë). Me qëllim dhënien e rezultateve sa më të shpejta, Komisioni propozon që instrumenti i transferimit të përkohshëm me pëlqim të ndërlidhet edhe me mekanizmin e lëvizjes paralele. Pra nuk e bëjmë thjesht vetëm për transferim të përkohshëm do ketë lidhje me lëvizjen paralele dhe me situatën që ne e prezantuar më përpara.

Në pozicionin nr. 491 kandidatët me 2 (dy) vlerësime janë z. {...} dhe znj. {...}. Sa i përket z. {...}, ai është i transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, po mbi skemën e lëvizjes paralele pasi është kandidat i vetëm në pozicionin nr.14 të vitit 2023. Pra e kemi transferuar që në vitin 2023 për sa kohë ai ishte kandidat i vetëm në atë procedurë. Është i njëjti mekanizëm. Kështu që, megjithëse ai kandidon në të njëjtin pozicion që është 491 aktualisht, me zonzjën {...}, atë e kemi transferuar përkohësisht kohë më përpara. Kështu që edhe këtë mekanizëm, këtë mundësi ne do t'ia ofrojmë zonzjës {...} pasi e konsiderojmë kandidate potenciale në pozicionin nr. 491.

Në pozicionin nr.492 ka vetëm një kandidat me dy vlerësime dhe ai është z. {...}. Është i vetmi. Kështu që procedurën e transferimit të përhoshëm do ta zbatojmë për zotën {...} duke e njoftuar nëse jep pëlqimin apo jo. Ndërsa në pozicionin nr. 493, kandidatë me dy vlerësime janë znj. {...} dhe z. {...}. Znj. {...} ne do t'ia bëjmë propozimin për pozicionin nr. 491, kështu që mbetet si kandidat i vetëm me dy vlerësime në këtë pozicion z. {...}. Për këtë pozicion ne do t'i kundërdrejtojmë propozimin tonë për t'u përfshirë në mekanizmin e transferimit të përkohshëm me pëlqim (për pozicionin nr. 493).

Këto janë propozimet tona dhe relacioni i përbashkët për të tria nominalisht projektvendimet e para.

Më pas, nëse në eventualitetin e dhënies së pëlqimit nga kandidatët, duhet të marrim pëlqimin e tyre sot dhe më tej do vijojmë me procedurat e transferimit të përkohshëm dhe afatin se kur duhet të fillojë ky transferim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarës znj. {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky votim ishte për vendimin që i adresohet znj. {...}.

Ilir Rusi: Ka diskutime për projektvendimin që i adresohet z. {...}?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projektvendimin i cili i adresohet z. {...}.

Keni diskutime?

Nuk ka diskutime.

Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për transferim të përkohshëm deri në një vit.

2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda ditës.

4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Nisur nga ato çfarë thamë në fillim të kësaj mbledhjeje që kjo mbledhje ka të bëjë edhe me misionin që kemi për efektivitetin dhe plotësimin e vakancave dhe sipas asaj çfarë ka parashtruar Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ftoj administratën të bëjë njoftimin e menjëhershëm të kandidatëve për të shprehur pëlqimin e tyre, nëse dëshirojnë të transferohen në këto pozicione të lira apo jo, sa më shpejt të jetë e mundur.

Në eventualitet të përgjigjes së tyre, transferimi i tyre do të diskutohet po në mbledhjen e ditës së sotme. *(është fjala për tre projektvendimet, nënpikat 6.4, 6.5, 6.6 të rendit.)*

(Sqarim: Ndërkohë që stafi i institucionit bën njoftimet përkatëse sipas mekanizmit të parashtruar më sipër nga ana e relatorit, për efikasitet dhe miradministrim të kohës mbledhja vijoi me trajtimin e pikave vijuese në rendin e ditës, çështjet nr. 7, nr. 8, nr. 9. Pas trajtimit të këtyre çështjeve, dhe pas marrjes së pëlqimit të gjyqtarëve për transferimin e përkohshëm, vijoi kjo pikë e rendit të ditës si më poshtë.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje dhe në vijim të procedurave të ndjekura për dhënien e pëlqimit për t'u transferuar, njëkohësisht edhe për t'u parë papajtueshmëria në lidhje me funksionin aktual të tyre, administrata kreu veprimet; kanë ardhur aktet përkatëse të cilat do të relatohen nga zoti Kurushi, mbi vijueshmërinë e shqyrtimit të tre akteve që kemi në lidhje me transferimin e tyre, për shkak të dhënies së pëlqimit dhe kryerjes së modaliteteve të tjera në lidhje me funksionin aktual që kanë në këtë moment.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Po vijoj me modalitetet e procedurës së transferimit.

Pasi përfunduar projektvendimet e mëparshme që hapën procedurën e transferimit të përkohshëm, kjo procedurë e transferimit të përkohshëm na sjell edhe vijimin e procedurës së marrjes së pëlqimit, pra bërjes së ditur kandidatit dhe marrjes së pëlqimit prej tyre nëse ata do të shprehnin interes për t'u transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Bashkëlidhur njoftimit kanë mbërritur edhe përgjigjet e të tre kandidatëve:

Zonja {...} ka dhënë pëlqimin në mënyrë elektronike e ka dërguar në adresën tonë zyrtare.

Zoti {...} ka dhënë pëlqimin në mënyrë elektronike dhe pëlqimi i tij është dërguar në rrugë elektronike në adresën tonë zyrtare.

Zoti {...}, edhe ai ka shfaqur interes dhe ka dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Por të tre këta kolegët tanë kandidatë, aktualisht në dhënien e pëlqimit janë në detyrë si zëvendëskryetarë të gjykatave respektive. Domethënë zonja {...} është zëvendëskryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; Zoti {...} është zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; dhe zoti {...} është zëvendëskryetar në detyrë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Kështu që, për t'u përfunduar procedura e transferimit të përkohshëm, referuar rregullores së transferimeve, do të duhej që edhe zëvendëskryetarët të paraqisnin dorëheqjen e tyre përpara gjykatave të tyre, në pozicionin e zëvendëskryetarit.

Kështu që në këtë pikë, na kanë ardhur edhe njoftimet e dërguara nga të tre kolegët, të tre kandidatët, të kërkesës që ata kanë paraqitur përpara gjykatave të tyre, për heqje dorë.

Është paraqitur kërkesa për heqje dorë e z. {...} (mban datën 25.09.2024 dhe është me nr. {...} prot., e protokolluar në Gjykatën e Dibrës).

Është kërkesa e datës 25.09.2024 me nr. prot. 1639, e protokolluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ku zoti {...} ka paraqitur dorëheqjen si zëvendëskryetar.

Dhe është paraqitur kërkesa me numër {...} prot., datë 25.09.2024 “Për heqjen dorë nga pozicioni i zëvendëskryetares”, i zonjës {...}, e protokolluar kjo kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ndodhur në këto kushte, janë plotësuar të gjitha kriteret ligjore të transferimit të përkohshëm kur ne kemi hapur procedurat. Kemi marrë pëlqimet e tyre si dhe jemi njoftuar edhe për dorëheqjet si zëvendëskryetarë dhe ndodhur në këto kushte, ne i kemi paraqitur KLGJ-së, si Komision, pranimin e kërkesës tashmë, për transferimin (pra propozimin tonë) e përkohshëm të gjyqtarëve z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Efektet juridike të vendimeve, për secilin vendim (pra vendimet janë në mënyrë nominale për secilin dhe unë po i them në mënyrë të përmbledhur bashkërisht), efektet juridike të transferimit fillojnë më datë 1 dhjetor 2024. Më falni, 01.10.2024.

Gjyqtarët përjashtohen nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatat ku ata kanë caktim të përhershëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioneve të Përgjithshëm Shkodër, Elbasan dhe Dibër.

Njëkohësisht të njëjtët gjyqtarë ngarkohen të përfundojnë të gjitha çështjet gjyqësore që kanë në gjykim në Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të

Përgjithshëm Shkodër, Elbasan dhe Dibër, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimeve "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

(Një nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Ato po, ato janë me vendim të Këshillit të veçantë dhe ajo është e njohur dhe s'kemi nevojë që ta diskutojmë edhe një herë tjetër nëse do japin dorëheqjen apo jo. Por kam përshtypjen se këta nuk janë të ngarkuar në çështje të veçanta në gjykata të tjera. Duhet ta verifikoj por kam përshtypjen se për ato kanë vendim Këshilli.

Njëkohësisht kemi urdhëruar që të pranohet që... për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarëve, për aq sa është e mundur, të mos jetë më i lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në kohën që ata do të vijnë në detyrë, pra të balancohet ngarkesa e këtyre që do vijnë në detyrë, me gjyqtarët që gjykojnë çështjet aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe të gjykohen në të gjitha kategoritë e çështjeve që i referohet pozicionit ku ata caktohen në mënyrë të përkohshme.

Këto janë propozimet tona për secilin nga kandidatët.

Nëse ka ndonjë gjë tjetër për ta diskutuar, jam i gatshëm. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Atëherë vazhdojmë me votimin e projektvendimit që ka të bëjë me transferimin e znj. {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtares znj. {...}...

Duke kërkuar ndjesë për një situatë teknike të teknologjisë në lidhje me komunikimin me të tretët, atëherë po ju lexoj edhe një herë vendimin.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares {...} në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.10.2024.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit ”arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Ngarkohet Zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarës {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, duke marrë në konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika e pestë e saj ka të bëjë me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Tiranë.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projektvendimin që ka të bëjë me gjyqtarin {...}.

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.10.2024.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit ”arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Ngarkohet zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, duke marrë në konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Tiranë, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me projektvendimin që ka të bëjë me gjyqtarin z. {...}.

Ka diskutime?

Nuk ka diskutime.

Votim!

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.10.2024.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve

gjqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit "arrest në burg" dhe "arrest në shtëpi" për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor.

5. Ngarkohet zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarit {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, duke marrë në konsideratë ngarkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Tiranë, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

6. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke ju falënderuar për prezencën, ju uroj mbasdite të mbarë, sepse me këtë pikë mbledhja deklarohet e mbyllur.¹

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

¹ Shih paragrafin "Sqarim" në faqen 10.

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj**** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Bledar Bajri*** (anëtar)

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 7. Albens Tabaku | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça* | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa* | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor **znj. Naureda Llagami**, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Emona Muçi**.

Shënim: Nuk mori pjesë në votimin e kësaj çështjeje z. **Markelian Koça**, i cili mori pjesë në këtë mbledhje nëpërmjet platformës “online”.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7. Ju bëj me dije se z. Koça nuk merr pjesë në

shqyrtimin, diskutimin dhe votimin e këtij projektvendimi.

Ky projektvendim ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Shkurtimisht, në mbledhjen plenare të datës 24.05.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, si edhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Është një vendim ku janë hapur në vitin 2023, ka qenë muaji maj 2023.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë si më lart u përcaktua deri më datë 14.06.2023. Pra ishte dy javë kohë, në qershor të vitit 2023 ishte afati përfundimtar i marrjes së kërkesave për të shfaqur interes në pozicionet e lira të shpallura në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ. Brenda afatit u paraqitën gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) kandidatura.

Në procedurat e ngritjes në detyrë të shpallura me vendimet nr. 235 – nr. 247 ka përfunduar procedura e verifikimit për disa kandidatë në këto pozicione. Këshilli për pozicionin nr. 243, me vendimin nr.483, datë 31.07.2024 vendosi: “Ngritjen në detyrë të gjyqtarës znj. {...}, në gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Për pozicionet e tjera Këshilli ka vendosur kualifikimin e disa prej kandidatëve dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira përkatëse dhe më konkretisht:

-Për pozicionin nr. 242, me vendimin e datës 24.09.2024 është kualifikuar kandidatja znj. {...}. Bëhet fjalë kualifikimi i bërë ditën e djeshme.

-Për pozicionin nr. 235, me vendimin nr. 350, datë 09.07.2024 është kualifikuar kandidatja znj. {...}. Pra është i korrikut të vitit 2024.

Sa më sipër, rezulton se në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 242 dhe nr. 235, datë 24.05.2023, ka kandidatë të kualifikuar. Është kusht i cili ne na mundëson për të vijuar më tepër procedurën e përzgjedhjes së relatorit për të vijuar ai më tej procedurat e renditjes dhe më pas ngritjes në detyrë.

Në vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Seksioni A, titulluar “Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit”, pika 24, parashikon se: “Këshilli, jo më vonë së 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit projektvendimin, pasi plotësohen kushtet për të vijuar me procedurën e përzgjedhjes për këto dy pozicione, “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, si edhe në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023”.

Propozimet e Komisionit:

Nëpërmjet këtij projektvendimi, sipas pikës 1 të tij, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, si edhe në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për

këto procedura përzgjedhjeje për emërim. Lidhur me këtë çështje, Komisioni mban në vëmendje se z. Markelian Koça nuk është përfshirë në këto procedura të ngritjes në detyrë, ndërsa z. Albens Tabaku nuk është pajisur me certifikatën e sigurisë.

Sa i përket relatorit për këto procedura përzgjedhjeje, bazuar në vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, propozohet që kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. Kurushi të përfundojë procedurat e përzgjedhjes për këto dy pozicione.

Projektvendimi është i strukturuar në dy pika të cilat janë bërë të ditur dhe të njohur të gjithë anëtarëve. Nuk po i lexoj për efekt kohe.

Përfundimisht i kërkojmë Këshillit të fillojë procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Si dhe të caktohem unë, z. Kurushi, si relator i procedurës së përzgjedhjes për të dyja këto pozicione.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën

Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi pakësimin e fondeve në programin 01110 dhe 03310 dhe rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj**** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Bledar Bajri*** (anëtar)
- 7. Albens Tabaku*** (anëtar)
- 8. Markelian Koça**** (anëtar)

9. Yllka Rupa*

(anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi pakësimin e fondeve në programin 01110 dhe 03310 dhe rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi pakësimin e fondeve në programin 01110 dhe 03310 dhe rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit, Drejtorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë.

Ministria e Financës, me shkresën nr. 11402/9, datë 02.09.2024, ka dërguar detajimin e ndryshimeve të buxhetit për sistemin gjyqësor, në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 28.08.2024 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Sipas këtij akti normativ, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, është pakësuar shuma 98,000 mijë lekë, (të gjitha në shpenzime personeli, artikulli 600 shpenzime paga) nga të cilat, në programin 01110 buxheti i KLGJ janë pakësuar në 18,000 mijë lekë dhe në programin 03310 buxheti i gjykatave, është pakësuar në shumën 80,000 mijë lekë.

Sikurse jeni në dijeni, me miratimin e buxhetit për vitin 2024, në dhjetor të vitit 2023, u miratua edhe detajimi i fondeve për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor për të tre programet buxhetore. Ndër të tjera u detajuan fonde edhe në shpenzime personeli artikulli 600 në paga, në të tre programet që përbëjnë grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në këtë moment, struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për buxhetin dhe menaxhimin financiar në gjykata (të cilat kanë konfirmuar me e-mail fondet buxhetore të lira), bëri një analizë të situatës buxhetore në gjykatat e të gjitha niveleve dhe institucionin e KLGJ, duke arritur në përfundimin se 3 gjykata kanë fonde të lira të papërdorura në shpenzime paga, si rezultat i mosplotësismit të vendeve vakante me magjistratë dhe vakanca në administratën gjyqësore, përkatësisht, në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe në buxhetin e KLGJ-së në shumën 18,000 mijë lekë.

Në përfundim të kësaj analize, në zbatim të Aktit Normativ kemi vlerësuar pakësimin e fondeve në programin 01110, në artikullin 600 shpenzime paga, në shumën 18,000 mijë lekë dhe në programin 03310 në artikullin 600 shpenzime paga, në shumën 80,000 mijë lekë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor dhe Aktin Normativ nr. 3, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e pakësimit të fondeve në sistemin gjyqësor, sipas pasqyrës së mëposhtme.

Kalojmë në paragrafin tjetër të relacionit që ka të bëjë me rishpërndarjen e fondeve në shpenzime korrente.

Sikurse jeni në dijeni, pas miratimit të buxhetit të 2024-s, është bërë detajimi i fondeve, ndër këto edhe në shpenzime korrente në programin 03310 “buxheti gjyqësor”.

Fondi i detajuar në shpenzime personeli ka qenë në shumën 3,379,700 mijë lekë, nga të cilat pjesa më e madhe e fondit iu detajua gjykatave, ndërsa u mbajt një pjesë e vogël e fondeve në administrim KLGJ 03310 me qëllimin e vetëm financimin e magistratëve të rinj dhe ndihmësve ligjorë të cilët do mbarojnë studimet dhe do emërohen në sistemin gjyqësor gjatë vitit buxhetor 2024.

Gjatë kësaj periudhe nga disa gjykata kanë ardhur kërkesa në shpenzime personeli (shpenzime paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Kanë ardhur kërkesa nga Gjykata e Shkallës së Parë Berat, nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga Gjykata Elbasan, Gjykata Fier, Gjykata Gjirokastrë, Gjykata Kukës, Gjykata Shkodër, Gjykata Tiranë, Gjykata Vlorë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje.

Në përfundim të një analize të buxhetit të kryer në shpenzime personeli, paga dhe sigurime shoqërore, rezultojnë se kërkesat për fonde shtesë nga gjykatat janë në shumën 53,000 mijë lekë. Si dhe nga analiza disponohen fonde të lira në shpenzime personeli, kemi vlerësuar rishpërndarjen e tyre sipas pasqyrave numër 1 dhe numër 2 që janë bashkëlidhur.

Kërkesa në shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (shpenzime operative).

Edhe në këtë artikull buxhetor janë disa gjykata që kanë kërkuar fonde shtesë, duke i argumentuar për shpenzime të energjisë elektrike, për shpenzime avokatie, shpenzime postare dhe pjesën më të madhe të tyre e zënë shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Kështu ka kërkuar Gjykata e Lartë, ka kërkuar Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm e Apelit Tiranë, Gjykata e Posaçme e Apelit e KKO-së, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan, Gjykata e Shkallës së Parë Fier, Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Gjykata e Shkodër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë e KKO-së, Gjykata Administrative e Apelit, Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Administrative e Shkallës së Parë Lushnje.

Në përfundim të një analize të situatës buxhetore, në artikullin 602, shpenzime operative, rezultojnë se kërkesat për fonde shtesë nga të gjithë gjykatat janë në shumën 193,393 mijë lekë (ku pjesën më të madhe e zënë vendimet gjyqësore, ku jo të gjitha kanë marrë formën e prerë apo janë zbardhur), ndërsa në fund të analizës fonde të lira na rezultojnë vetëm në shumën 6,000 mijë lekë, kjo i përket nga fondet e detajuara për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Gjykata për të plotësuar nevojat e saj deri në fund të vitit ka përdorur rezerva të karburantit, kështu që fondi i planifikuar nga kjo gjykatë për nënartikullin “Blerje Karburanti” në shumën 6,000 mijë lekë rezulton i papërdorur.

Në këto kushte, ku në programin 03310, në shpenzime për “Mallra dhe Shërbime të tjera”, nuk disponojmë më fonde të tjera të lira, vlerësojmë që fondet e sipërcituara të rishpërndahen sipas pasqyrës nr. 3, bashkëlidhur.

Kështu, për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimin) e fondeve buxhetore, programi 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (artikulli 600, artikulli 601, artikulli 602), për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij relacioni.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, janë detajuar fonde edhe në shpenzime kapitale në kodin e projektit studime dhe projektme në shumën 28,000 mijë lekë, në administrim

KLGI 03310, me qëllimin e vetëm hartimin e projektit të zbatimit për godinën e re të Gjykatës së Lartë, gjatë vitit buxhetor 2024.

Siç jeni në dijeni, ky projekt nuk u realizua për mungesën e vënies në dispozicion nga organet kompetente të sheshit të ndërtimit për këtë gjykatë.

Nga ky fond i detajuar në fillim të vitit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detajuar një pjesë të fondeve, me vendimin nr. 330, datë 03.7.2024, në favor të Gjykatës së Shkallës së Parë për hartimin e projektit të BMS-së dhe VRF-së (sistemi i ngrohje-ftohjes dhe sistemi i menaxhimit të godinës). Në lidhje me këtë analizë, Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit, me memon datë 23.09.2024 ka kërkuar të shihet mundësia për disponim fondesh të lira, të cilat i nevojiten për blerje pajisjesh elektronike për nevoja të gjykatave pasi realizimi i blerjes së pajisjeve elektronike, gjatë vitit 2024 ishte shumë më e vogël se sa kërkesa e paraqitur nga gjykatat, si dhe me qëllimin e vetëm për të lehtësuar me këtë blerje edhe buxhetin e vitit 2025 pasi kërkesat e ardhura nga gjykatat për blerje pajisje elektronike për vitin 2025, janë në shumën 124,200 mijë lekë. Bashkëlidhur keni memon e përgatitur nga Departamenti i IT-së.

Pas analizës së situatës së fondeve buxhetore në shpenzime kapitale, në kodin “Studime dhe projekte”, rezultojnë fonde të lira 21,150 mijë lekë, të cilat janë administruar në KLGI 03310, dhe për këtë vlerësojmë rishpërndarjen (transferimin) e këtyre fondeve për plotësimin e nevojave të sistemit gjyqësor në artikullin 231, kodi i projektit 21AC401 “Blerje pajisje elektronike”.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimin) së fondeve buxhetore, në programin 03310, në shpenzime kapitale (investime), në shumën 21,150 mijë lekë, për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrës së mëposhtme.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pritjeje të mundshme.

Ju faleminderit edhe një herë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Në shqyrtimin e kësaj pike u rikthye zoti Koça. (*zoti Koça është “online”*)

Meqenëse s’ka diskutime, vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi pakësimin e fondeve në programin 01110 dhe 03310 dhe rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.09.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara nga relatori , znj. Gentiana Muçaj”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:06 dhe mbaroi në orën 15:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj**** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Bledar Bajri*** (anëtar)

7. *Albens Tabaku* (anëtar)
8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara nga relatori, *znj. Gentiana Muçaj*”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e

Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara nga relatori, znj. Gentiana Muçaj”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Atëherë, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} janë kandidatë për ndihmës ligjorë, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor, në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024.

Në kushtet kur, përbërja e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka pësuar ndryshime, sipas vendimit nr. 486, datë 13.09.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar, është e nevojshme që për vazhdimin e procedurave të kualifikimit për znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, të caktohet relatori i ri.

Tre kandidatët kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024. Procesi ndodhet aktualisht në fazën e procedurës së kualifikimit dhe vijimin e procedurës të emërimit në shërbimin civil gjyqësor.

Zonja {...} është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 359, datë 11.07.2024.

Zonja {...} është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 323, datë 03.07.2024.

Zoti {...} është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, me vendimin e KLGJ-së nr. 325, datë 03.07.2024.

Në vijim, Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. {...} prot., datë 01.08.2023, ka përcjellë vendimin e saj me nr. 29, datë 30.07.2024, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, duke vendosur miratimin e listës së kandidatëve fitues, duke i renditur sipas pikëve që ata kanë marrë në vlerësimin përfundimtar në Programin e Formimit Fillestar.

Në përfundim, në kushtet kur zonja Llagami, njëkohësisht Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të jetë relatores në procesin në të cilin Komisioni ose Këshilli duhet të miratojë aktet administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose nëpunësve civilë gjyqësorë në përputhje me nenin 62/4 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, për një shpërndarje sa më të drejtë dhe të barabartë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe raporteve mes anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë mes anëtarëve të këtij komisioni, vlerësohet që procedura e verifikimit për kandidatët për ndihmës ligjorë, si më sipër, t’i caktohet z. Ridvan Hado, meqenëse edhe relatori i mëparshëm ka qenë gjyqtar.

Struktura e projektvendimit përbëhet nga dy pika. Në pikën e parë projektvendimi parashikon caktimin e relatorit Ridvan Hado në procedurën e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024, të papërfunduara nga relatorja, znj. Gentiana Muçaj.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet detyrimi i njoftimit të vendimit kandidatëve për ndihmës ligjorë, sipas pikës 65 të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Dhe në fund të projektvendimit përcaktohet edhe hyrja në fuqi e këtij vendimi, konkretisht menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Bledar Bajri: Dakord.

Albens Tabaku: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit në procedurat e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara nga relatori, znj. Gentiana Muçaj”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi sipas relacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Mbledhja ende vazhdon² sepse njoftohem nga administrata që kanë ardhur pëlqimet dhe po presim konfirmimin e tyre me qëllim që të vijojë mbledhja dhe për të përfunduar edhe atë pikë të rendit (pika 6). (*shih procesverbalin e pikës 6*).

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

² Kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës sipas rendit të njoftuar. Mbledhja vijoi me trajtimin e nënçështjeve 6.4, 6.5, 6.6 të cilat u lanë për t’u trajtuar në fund të mbledhjes, pas marrjes së pëlqimit nga tre gjyqtarët për transferimin e përkohshëm. Për më shumë, shih procesverbalin e pikës 6, nga fq.10 e deri në fund ku edhe mbyllet mbledhja.